



## K.R.U"Hydroregjioni jugor"Sh.A.me seli në Prizren

Në bazë të neninit 7.pika 2. Statutit të KRU"Hydroregjioni jugor"Sh.A., me datë 01.10.2010, Bordi të Drejtorëve KRU"Hydroregjioni jugor"Sh.A.me seli në Prizren, aprovoi këtë :

### **RREGULLORE PËR MBROJTJE KUNDËR ZJARRIT**

#### **Dispozitat e përgjithshme**

##### **Neni 1.**

Me këtë rregullore më për së afërmi përcaktohen masat mbrojtëse kundër zjarrit.

Organizimi i mbrojtjes kundër zjarrit , rrethi i detyrave dhe autorizimeve të punëtorve të Kompanisë :

Mënyra e kryerjes të kontrollës së brendshme , aplikimi i masave mbrojtëse nga zjarri si dhe detyrat ,autorizimet dhe përgjegjësit e punëtorëve të cilët kryejn këtë kontrollë ;

Mënyra e njoftimit të punëtorve me masat e rrezikshmëris nga zjarri si dhe mënyra e reagimit në rast zjarri ;

Mjetet dhe pajset teknike për shurjen e zjarrit ;

Përgjegjësia e punëtorve në rast mos përmbushje të masave mbrojtëse nga zjarri ;

Detyrat e punëtorve në rast të lajmrimit të zjarrit si dhe pjesmarja në shurjen e zjarrit .

## Neni 2 ,

Mbrojtja nga zjarri përfshin një seri normash dhe masa të cilat caktohen me qëllim të pengimit , të zgjerimit , lokalizimit, dhe shuarjes së zjarrit, shpëtimit të njerëzve dhe të mirave materiale , të cilat mund të rrezikohen nga zjarri .

Mbrojtja nga zjarri organizohet dhe aplikohet në të gjitha objektet dhe hapsirat ku ekziston rreziku nga shfaqja dhe përhapja e zjarrit në KRU”Hidroregjioni Jugor” SH.A.

## Neni 3.

Për organizimin e mbrojtjes nga zjarri dhe funksionimin e suksesshëm janë përgjegjës dhe të obliguar:

- Rojtarët
- Kolegiumi i Kompanisë
- Kryeshefi Ekzekutiv
- Drejtorët e Departamenteve (sektoreve)
- Udhëheqësit e Objekteve
- Punëtorët tjerë të Kompanisë

## Neni 4 .

Masat mbrojtëse nga zjarri të përshkruara në këtë rregullore dhe akte tjera të Kompanisë në pajtueshmëri me ligjin , kanë për detyrë të respektojnë të gjithë punëtorët që janë në marrëdhënie pune dhe personat të cilët gjenden në objektin e Kompanisë dhe në afërsi të sajë

### **Masat mbrojtëse kundër zjarrit**

## Neni 5.

Mbrojtja nga zjarri realizohet në Kompani me zbatimin e masave të normave organizativo- teknike , preventive , profesionale dhe të natyrës tjetër .

Mbrojtja nga zjarri organizohet dhe zbatohet në të gjitha vendet dhe objektet të cilave ju kanoset rreziku nga zjarri .

## Neni 6 .

Në kuader të tejkalimit të shkaqeve të zjarrit , ndalimit të lajmrimit të zjarrit , përhapjes dhe shurjes së zjarrit , shpëtimit të njerëzve dhe pasurisë (pronisë) të

rrezikuar nga zjarri në objektin e drejtorisë, objektin për prodhimin dhe distribuimin e ujit , mirren këto masa mbrojtëse nga zjarri :

- Në rast të ngritjes , adaptimit , rekonstruktimit të ri dhe objekteve ekzistuese , aparateve , instalimeve ndermiren rregullat ligjore , normative , teknike dhe standardeve mbrojtëse kunder zjarrit ;

- Ndërtesa e drejtorisë si dhe objektet tjera të KRU "Hidroregjioni Jugor" , duhet të jenë të paisura me aparate dhe paisje për shurjen e zjarrit;

- Numri dhe lloji i këtyre aparateve si dhe lokacioni i tyre përcaktohen mvarsisht nga nevoja dhe mundësia e ofrimit të ndihmes për mbrojtjen kunder zjarrit;

- Punët me zjarr të hapur , aparateve salduese , për nevoja të mirmbajtjes së operatives , kryhen në objekte të posaqshme mbrojtëse nga zjarri dhe ndermiren masa adekuate të mbrojtjes nga zjarri;

- Lokacioni i depove me materjal ndezës rregullohen në kuader të rregullores për mbrojtjen nga zjarri dhe sigurimi i plotë i njerzve dhe objektit ;

- Ndertimi i objekteve të përkohshme kryhen në largësi prej së paku 10. m nga objektet tjera dhe depove me materjal ndezës ;

- Bocat me gazra pluhur dhe gazra në gjendje të lëngët përdoren në harmoni me rregullat ekzistuese ,

- Materiali i hargjuar masti , vaji , ambalazhet plastike si dhe materjali tjetër i pa përdorshëm duhet që mbas përfundimit të ndrrimit të lihen në vende të posaqshme.

- Aparatet , nxemset mund të përdoren vetem nese jan teknikisht të rregullta .

**III – Organizimi i mbrojtjes nga zjarri , rrethi i detyrave dhe autorizimeve të organeve drejtuese dhe punëtorve tjerë.**

Neni 7 .

Për aprovimin dhe përparimin e punëve dhe detyrave nga lëmia e mbrojtjes nga zjarri në KRU "Hidroregjioni Jugor" janë kompetent dhe përgjegjës.

- Kolegiumi i Kompanisë
- Kryeshefi Ekzekutiv
- Drejtoret e shërbimeve
- Udhëheqësit e Objektit
- Komisioni për mbrojtjen kunder zjarrit dhe
- Punëtorët tjerë të Kompanisë .

## Neni 8 .

### **Kolegiumi i Kompanisë**

Kolegiumi i Kompanis në kuader të kompetencave të përcaktuara me statut përcakton politiken mbrojtëse nga zjarri si dhe mbrojtjen e punëtorve dhe të pasurisë .

#### **Kolegiumi i Kompanisë i kryen punët vijuese .**

- bjen akte të përgjithshme , plane dhe programe në të cilat rregullohet mbrojtja nga zjarri .
- shqyrton masat kundër zjarrit dhe bjen vendime për eliminimin e rrezikut nga zjarri ,
  - ndërmer masa mbrojtëse kundër zjarrit ;
- përcjellë gjendjen e organizimit , pregaditjen teknike profesionale të kuadrove për shurjen e zjarrit si dhe përparimin e mbrojtjes kundër zjarrit;
- përpilon planin financiar për nevoja materiale si dhe mjetet për organizimin e mbrojtjes kundër zjarrit,
- e emron komisionin për mbrojtje nga zjarri ( nese është e nevojshme edhe përpilimin e pyetjeve profesionale nga lëmia e mbrojtjes nga zjarri ) në këtë komision mund të emrohët
- personi që nuk është në mardhënje pune në Kompani ;
- kryen edhe punë tjera të cilat janë në kompetencën e tijë .

## Neni 9 .

### **Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë**

KE i Kompanis nga lëmia e mbrojtjes nga zjarri ka këto të drejta dhe detyra :

- Emron komisionin e përgjithshem në Kompani dhe zbatimin e masave mbrojtëse nga zjarri , organizimin e punëve kundër zjarrit ;
- Kujdeset për zbatimin e vendimeve të Kolegiumit të Kompanisë nga lëmia e mbrojtjes nga zjarrit ;
- Kujdeset për furnizim me mjete teknike dhe mjeteve të nevojshme për mbrojtjen dhe shurjen e zjarrit ;
- Kujdeset për zbatimin e masave mbrojtëse nga zjarri ;
- Ndermer të gjitha masat e nevojshme për montimin , rregullimin e aparateve për mbrojtjen kundër zjarrit ;
- Është përgjegjës për zbatimin e masave mbrojtëse nga zjarri para planifikimit të ndertimit rekunstruimit ose adaptimit të objektit ;
- Kryen edhe punë tjera të cilat janë të përcaktuara me norma dhe vendime të Kolegiumit të Kompanis që i lihen në përgjegjësi .

Neni 10 .  
**Drejtorët e sektorve**

Në kuader të zbatimit të masave mbrojtëse nga zjarri, të gjithë drejtorët e sektorve kanë detyrë dhe përgjegjësi të :

- kontrollojnë organizimin dhe zbatimin e masave mbrojtëse nga zjarri të caktuara me këtë rregullore;
- I njoftojnë punëtorët me rrezikun i cili lajmrohet në përhapjen e zjarrit nëse punëtori vet e ka shkaktuar zjarrin ose nga ana e punëtorve apo personit të tretë;
- I njoftojnë punëtorët me rrezikun nga zjarri dhe masat mbrojtëse si dhe reagimin në rast të zjarri ;
- kujdeset për furnizim me mjete teknike dhe mjeteve të nevojshme për mbrojtjen dhe shurjen e zjarrit ;
- e lajmrojnë drejtorin e kompanisë për marrjen e masave urgjente të mbrojtjes nga zjarri, për derisa ato nuk janë në gjendje që vet me sukses të ndermarin masa për shurjen e zjarrit;
- udhëheqë akcionin e shurjes së zjarrit , shpëtimin e njerzve të rrezikuar dhe pasuris deri në momentin e ndermarjes të akcionit nga ana e zjarrfikësve ;
- i propozojnë organit përkates të Kompanisë për furnizim me aparate për shurjen e zjarrit ;
- rregullisht kryen kontrollën e gjendjes së materialit i cili është i rrezikshëm për ndezje ;
- kryen edhe punë tjera nga lëmia e mbrojtjes nga zjarri në kuader të normave dhe vendimeve përkatëse të kolegiumit të kompanisë .

Neni 11.

Për percjelljen , organizimin e suksesshëm dhe mbrojtjes kundër zjarrit si dhe sistemi i masave mbrojtëse nga zjarri , Bordi Ekzekutiv i Kompanisë bënë trajnimin e grupit kundër zjarrit.

Grupi trajnohet nga kuadri teknik profesional e në të mund të emrohen edhe punëtorët profesional të cilët nuk janë në marrdhënje pune në Kompani .

Detyrat e grupit janë:

- Së paku dy herë në vit të kryejn kontrollën e objektit më qëllim të parandalimit të rrezikut nga zjarri dhe të jep propozim për ndermarjen e masave më adekuate kundër zjarrit .
- në rast nevojë mund të kryhet kontrollimi i jashtzakonshëm i disa objekteve dhe ambientit të cilët janë të rrezikuar nga zjarri :
- jep raport për gjendjen ekzistuese dhe propozon masa mbrojtëse kundër zjarrit kolegiumit të kompanisë për prurjen e vendimeve adekuate .

- analizon gjendjene organizimit te kuadri , pregaditjeve teknike të mjeteve dhe aftësimin të përgjithshem për shpejtësi dhe efikasitetin e shurjes së zjarrit si dhe shpëtimin e njerëzve të rrezikuar dhe pasurisë në propozim të kolegiumit të Kompanisë për ndermarjen e masave përkatëse ;
- kryen mbikqyrjen në aftësimin profesional të punëtorve nga lëmia e mbrojtjes nga zjarri :
- bjen planin e mbrojtjes nga zjarri dhe planin perspektiv të zhvillimit të mbrojtjes kunder zjarrit dhe organizimin në kuader të planit të Komunës , dhe i jep Kolegiumit të Kompanisë për miratim ,
- Propozon Kolegiumit të Kompanisë ndryshime dhe plotësimet e rregullores të mbrojtjes Kunder zjarrit .

Neni 12 .

### **REFERENTI PËR MBROJTJEN NË PUNË**

Referenti për mbrojtjen në punë është përgjegjës :

- kryen mbikqyrjen mbi aprovimin e masave të caktuara të mbrojtjes nga zjarri ,
- bënë analiza , informata dhe raportin mbi gjendjen dhe problemet e mbrojtjes nga zjarri , si dhe organizimin dhe pregaditjen teknike ,
- jep udhëzime më të afërta , vërejtje për disa objekte në bazë të specifikacionit në lidhje me rrezikun e zjarrit , mënyren e mbrojtjes si dhe veprimin në rastë zjarri dhe merë masa që i njejti të përdoret , a në bazë të nevojës të arrijë në vendin e ngjarjes ,
- organizon dhe kujdeset për evidencen e rregullt nga lëmia e mbrojtjes kunder zjarrit ,
- përcakton kushtet nën të cilat mund të shfrytëzohen paisjet për shurjen e zjarrit të hapur , aparatet për saldim dhe paisjet tjera që punojnë me lëndë djegëse , gazrave djegëse ose bëhet largimi i tyre në vende të caktuara ,
- në marveshtje me udhëheqësit e sektorve ose të objekteve organizon aftësimin profesional të punëtorve të punësuar nga lëmia e mbrojtjes në punë dhe mbrojtjes kunder zjarrit ,
- kontrollon nevojat dhe propozon referentit për furnizim me pajisje adekuate , pregaditje dhe mjete për evitimin e zjarrit , lajmrimin dhe shurjen e zjarrit në mënyr efikase ,
- mbanë evidencen e punëtorve të cilët kanë kryer kurse nga mbrojtja kunder zjarrit ,si dhe punëtorët të cilët janë të detyruar të intervenojnë në rastë rreziku nga zjarri të objektit ,

- propozon iniciimin e procedurës për shkak të shkeljeve , detyrave punuese ndaj punëtorve që nuk i përmbahen dhe nuk i aprovojnë masat mbrojtëse nga zjarri ,
- në bazë të nevojës merë pjesë në komision të cilat përcaktojnë shkaqet e zjarrit ose eksplozivit ,
- bashkëpunon me shërbimin e mbrojtjes kundër zjarrit të organit komunal për miratim dhe zbatimin e masave mbrojtëse nga zjarri të përcaktuara me akte të përgjithshme ,
- kryen edhe punë tjera të cilat janë të rregulluara me akte interne që i takojnë përgjegjësisë së tijë .

Neni 13 .

### **PERGJEGJËSIA ,DETYRAT E PUNËTORVE PËR MBROJTJEN KUNDER ZJARRIT**

Të gjithë punëtorët në mardhënje pune në Kompani kanë për detyrë:

- që në vendin e punës të njohtohet me rrezikun nga zjarri dhe ti zbaton masat mbrojtjes kundër zjarrit në kuader të rregullores dhe vendimit të organit kompetent të mbrojtjes kundër zjarrit ,
- të kujdeset për rregullsinë ,përdorshmerinë e paisjeve kundër zjarrit dhe mjeteve që janë të drejtuara për fikjen e zjarrit
- mbas punës së kryer në objektet punuese të evitojnë rrezikun i cili mund të jetë si shkaktarë i zjarrit eksplozivit ose të ndonjë fatkeqësie tjetër ( ti çkyqë mjetet elektrike , të shuaj zjarrin , të largoj lëndet djekse dhe materjalin tjetër të rrezikshëm )
- Të gjitha prishjet dhe demtimet në makinat prodhuese , paisjeve elektrike , instalimet ,dhe paisjeve tjera prej të cilave mund të rrezikohet siguria e objektit pasuris menjëherë të lajmroj shërbimin profesional për të marrë masa për largimin e tyre ,
- Kur të lajmrohet zjarri ka për detyrë urgjentisht të lajmron njësinë e zjarrfikësve dhe menjëherë të ndërrmarin masat e nevojshme për shurjen e zjarrit .

#### Neni 14.

### **IV – MËNYRA E NJOHËJES SË PUNËTORVE ME MASAT DHE RREZIKUN NGA ZJARRI DHE NDERHYRJA NË RASTË RREZIKU**

Punëtori përgjegjës ka për detyrë ta njoftoj secilin punëtor të ri që fillon punën në Kompani me rrezikun nga zjarri si dhe mënyren si të mbrohët nga zjarri në rast të shfaqjes së zjarrit, njoftimi bëhet me biseda individuale .

#### Neni 15.

Në rast të lajmërimit të zjarrit secili punëtor ka për detyrë :

- të lajmrojë udhëheqësin përgjegjës dhe njësitin e zjarrfikësve , e menjëherë me mjetet disponuese të merr pjesë në shurjen e zjarrit.
- Me arrijten e njësisë së zjarrfikësve të gjithë punëtorët që gjenden në afërsi të zjarrit me leje e udhëheqësit kanë për detyrë të vihen nën komandën e njësisë së zjarrfikësve dhe të zbatojnë urdhërat e tyre .

#### Neni 16.

Në kuadër të shurjes së zjarrit dhe shpëtimit të njerëzve dhe pasurisë udhëheqësi i njësitit të zjarrfikësve ka të drejtë:

- Ta ndalojë qëndrimin e personave në vendin ku është lajmëruar zjarri për ata që nuk marrin pjesë në shurjen e zjarrit
- urdhëron largimin e personave dhe materialit nga objekti i cili rrezikohët nga zjarri ,
- urdhëron ndërprejen e rrymës .

### **V – MËNYRA E KRYERJES SË KONTROLLËS , NDERMARJA E MASAVE MBROJTËSE SI DHE PËRGJEGJËSIA DHE AUTORIZIMIET E PUNËTORVE TË CILËT E KRYEJN KËTË KONTROLLË.**

#### Neni 17.

Me kontrollë të mbrendëshme të mbrojtjes nga zjarri nënkuptoëhet nderrmarrja e masave profesionale nga punëtorët e inkuadruar në Kompani të përcaktuar me këtë rregullore.



## Neni 18.

Të drejtat dhe detyrimet nga neni 9,10,12,13, punëtorët në pajtushmerin ligjit për kryerjen e kontrollës janë të detyruar sidomos:

- që rregullisht të kryejnë kontrollë vizuale ambientit dhe rrethit të objektit si dhe paisjeve ,
- çdo 15 ditë të bëjnë kontrollë vizuale paisjeve dhe mjeteve për shurjen e zjarrit ,
- për çdo mungesë evidente menjëher të menjanoj dhe të kërkon ndihmë sherbimit profesional
- të bashkëpunoj me inspektionin të mbrojtjes kunder zjarrit dhe të njejtin të lajmroj për masat e ndermara në bazë të vendimeve të tyre ,
- në rastë zjarri menjëherë të lajmëroj inspektionin për zjarrin e shkaktuar ose për çdo rrezik i cili mund të ngacmohët nga zjarri ose eksplozivi që rrezikohet jeta e njerzve dhe pasurisë,
- të kujdeset për kontrollëtë rregullt të instalimeve të rrymës , enve me shtypje , depot e naftes dhe materje tjera të përcaktuara me ligj.

## **Vi – PËRGJEGJËSIA E PUNËTORVE PËR MOS RESPEKTIMIN E MASAVE MBROJTËSE NGA ZJARRI**

### Neni 19.

Të gjithë punëtorët e K.R.U”Hidroregjioni Jugor” janë përgjegjës për aplikimin dhe mirmbajtjen e paisjeve kunder zjarrit të përshkruar me këtë rregullore dhe me ligjë. Mosrespektimi dhe mospërmbajtja të masave kunder zjarrit konsiderohet shkelje e rendë e detyrave të punës , për çka punëtorit mund ti shqiptohet masa disiplinore në kuader të akteve të Kompanisë.

Përgjegjësinë për aplikimin e masave mbrojtëse nuk e përjashton punëtorin nga përgjegjësia .

### Neni 20.

Në të gjitha objektet e Kompanis “Hidroregjioni Jugor”, duhet që në vendet më të pështatshme dhe adekuate të jenë të vendosura aparatet e zjarrit.

Neni 21

Pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet çdo rregullore apo rregull tjetër i mëparshëm mbi menaxhimin e depos.

Neni 22

Kjo Rregullore hyn në fuqi në datën e aprovimit të së njëjtës nga Bordi i Drejtorëve të K.R.U “ Hidroregjioni Jugor” SH. A. – Prizren.

Datë : 01.10.2010

Prizren

KRU “ Hidroregjioni Jugor” SH. A. – Prizren

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve

---

Mr.sci.Naser Bajraktari